



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 48, datë 25.09.2024

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “STRUKTURË
ADMINISTRATIVE 4-6-17-18-19 KATE MBI TOKË ME 4 KATE NËNTOKË, “UNION
BANK -HQ ALBANIA”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “BAJRAM CURRI”,
BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Union Bank” sh.a, “Auto-City” sh.a dhe “Arch Investor” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë Administrative 4-6-17-18-19 kate mbi tokë me 4 kate nëntokë, “Union Bank -HQ Albania”, me vendndodhje në Bulevardin “Bajram Curri”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqëritë “Union Bank” sh.a, “Auto-City” sh.a dhe “Arch Investor” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I TËNËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 02/05 2025